

VENDIM
Nr. 123, datë 13.2.2020

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 594, DATË 31.8.2016, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK, TË
PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË
PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “VIJA BREGDETARE E QYTETIT TË
VLORËS, FAZA 1, SHTESA, PJESA LINDORE”, VLORË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe të ligjit nr. 99/2018, “Për buxhetin e vitit 2019”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 594, datë 31.8.2016, të Këshillit të Ministrave, numri i pasurisë me numër rendor 4, në tabelën 2/A, “Shtesa në zonën I, Skelë - Shkolla e Marinës”, ndryshon dhe bëhet 23/99+1-8.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Bashkia Vlorë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Vlorë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama